



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:278343

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05279464

P.2023:282772

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, dhe bashkëpunëtori profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S, i shpallur fajtor për veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 1896/2023 të datës 13.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 15.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij – Avokat Q. B., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: A.S nga Mitrovica Rr.”...” nr., i lindur më datë ..., nga i ati H... dhe e ëma Z...e gjinisë T., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 19.10.2023 rreth orës 15:30h, në hyrje të kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës me Maqedoninë e Veriut, saktësisht në pikën kufitare - Hani i Elezit, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të shfrytëzimit të dokumentit të falsifikuar si origjinal me dije ka përdorur dokumentin e falsifikuar, në atë mënyrë që me qëllim të kalimit të kufirit tek autoritetet policore kufitare ka prezantuar dokumentet e nevojshme për të hyrë brenda territorit të Republikës së Kosovës, ku në mesin e këtyre dokumenteve ka prezantuar edhe patentë shoferin të shtetit Belg me nr. serik:..., ashtu që nga zyrtari policor kufitar është vërejtur se dokumenti i dyshuar ka pasur mungesë të tipareve të sigurisë, i njëjti dokument është sekuestruar dhe dërguar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë për vërtetësinë e tij, me ç'rast nga raporti i ekspertimit me numër referues ... i datës 30.11.2023, është dhënë konstatimi dhe mendimi përfundimtar ku ka rezultuar se patent-shoferi me nr... është Falsifikim i Plotë.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë 400€ (Katërqind euro), të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 2 këste të barabarta në afat prej 2 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Konform nenit 276 paragrafi 2 pika 2.5 të KPP-së, patentë shoferi i shtetit Belg me numër serik:1262415153, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1896/2023 të datës 13.12.2023, kundër të pandehurit A.S, për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 15.01.2024

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë sa i përket aktakuzës që është ngritur kundër tij. Pranimin fajësisë e bën në mënyrë vullnetare duke shprehur keq ardhje, duke kërkuar falje dhe duke im premtuar gjykatës se as njëherë nuk do të përsëris një veprë penale të njëjtte apo do një tjetër, e sa i përket llojit të dënimit kërkoj nga gjykata që të nijetit ti shqiptoj një dënim me gjobe sa me të ulte të mundshme pasi që i nijeti është në gjendje të dobët ekonomike jeton së bashku me anëtar të familjes që të gjithë janë të pa pune madje e ka në përkujdesje edhe prindin e tij i cili e ka statusin e invalidit për shkak të problemeve shëndetësore që i ka. Pikërisht për këta arsye po e paraqes një kërkesë të tillë siç ke dënimi me gjobe madje duke kërkuar nga gjykata që të nijetin ta ndaj në dy këste.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se Deklaron nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale për të cilën është akuzuar në bazë të kësaj aktakuze pasi që një pranim të tillë e bëri vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, gjykata ta bëj pranimin e fajësisë dhe me rastin caktimit të llojit të lartësisë së dënimit të marrë parasysh si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë ndërsa si rrethana rënduese shkallën e përgjegjësisë penale motivet për kryerjen e veprës penale dhe rrethanë për të cilat është kryer vepra penale. Po ashtu kuptim nenit 92 të

KPPRK-së lidhur me nenin 269 të i ka propozuar gjykatës ta bëjë konfiskimin e patentë shoferit siç është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale **Falsifikim i dokumentit** nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, është përnduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj,

që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për konfiskimin

Konform nenit 276 paragrafi 2 pika 2.5 të KPP-së, patentë shoferi i shtetit Belg me numër serik:1262415153, është konfiskuar në mënyrë të përhershme, pasi që i njëjti është send që nuk mund të jetë në qarkullim, pasi që i njëjti është i falsifikuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:282772, më datë 02.02.2024

Procesmbajtësi:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.